

## KONTRATË SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, më datë 09.07.2019(nente korrik dymijë e nentembdhjete) në selinë e shoqërisë « Bezo Consulting shpk», Rruga « Don Bosko » Pallati Meldi, Ap. 8, në prani të ortakëve të shoqërisë, u nënshkrua kjo kontratë shitje kuotash nga palët e mëposhtme :

### **Shitësi :**

- **Nadire Bezo**, atësia Qazim, lindur më dt. 20.12.1954 në Krujë dhe banues në Tirane, në adresën Rr. « Mine Peza », Pall. 147/A ap. 8, shtetase shqiptare, madhore me zotësi juridike për të vepruar, me letërnjoftimi me nr. 024460352, ortak e shoqërisë « Bezo Consulting shpk. », zotërues<sup>e</sup> Ikuote në shoqëri.

### **Blerësi :**

**Bledi Bezo**, atësia Ylber, lindur më dt. 03.11.1987 në Gramsh dhe banues në Tiranë, në adresën Rr. « Mine Peza », Pall. 147/A ap. 8, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, me pasaportë nr.BE6898750, ortak e shoqërisë « Bezo Consulting shpk. », zotërues i 1 kuote në shoqëri.

### **Objekti i Kontrates :**

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë me Vendimin e saj nr.3 date 20.06. 2019, bazuar në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 « Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare » dhe Statutit të shoqërisë, ka vendosur :

- Miratimin e Shitjes së 1 kuotae, që përfaqësojnë 50% të kapitalit të shoqërisë, me vlere te pergjithshme 50.000 leke nga ortaku Nadire BEZO dhe transferimin nepermjet shitjes se tyre ne favor te ortakes ekzistuese, Bledi BEZO.

### **Çmimi i shitjes**

Çmimi i shitjes së 1 kuot, që përfaqëson 50% të kapitalit të zotëruar nga ortaku Nadire Bezo dhe që transferohet nëpërmjet kësaj kontrate në favor të ortakut Bledi Bezo, është 50.000 lekë.

Bleresit sipas paragrafit më sipër kanë paguar jashtë selisë se shoqërisë, plotësisht çmimin e shitjes dhe pala shitëse deklaron se ka marrë çmimin e plotë të shitjes dhe se midis tyre nuk ka asnjë pretendim.



### Garancitë


Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotave që po transferon nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

### Heqje dorë nga të drejtat dhe detyrimet

Pala shitëse deklaron nën përgjegjësinë e saj personale se heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë mbi kuotën e zotëruara në shoqëri që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë dhe shitur sipas kësaj kontrate.

Kjo kontratë u hartua në 4 (katër) kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe. Palët deklaruan se janë dakord me sa më sipër dhe, pasi e lexuan, e kuptuan, e nënshkruan regullisht atë në prani të palëve:

**Shitësi: Nadire BEZO**

Nadire Bezo  


**Blerësi: Bledi BEZO**

Bledi Bezo  
